

BORXHI NDËRKOMBËTAR I TRASHËGUAR
NGA KOSOVA NË
KONTEKSTIN E ‘FINALES SË MADHE’
EVENTUALE NDËRMJET
KOSOVËS DHE SERBISË

Tetor 2019

Mbështetur nga:



Norwegian Embassy



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja. I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM

MBI

BORXHIN NDËRKOMBËTAR TË TRASHËGUAR NGA KOSOVA NË KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBIË

Tetor 2019

STUDIM

MBI

BORXHIN NDËRKOMBËTAR TË TRASHËGUAR **NGA KOSOVA NË KONTEKSTIN E 'FINALES SË** **MADHE' EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE** **SERBISË**

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Tetor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
Hyrje	1
Burimet e brendshme ligjore dhe fushëveprimi i detyrimit të Kosovës për të përbushur shlyerjen e borxhit ndërkombëtar të trashëguar	1
Përvoja e ish-shteteve të tjera jugosllave: Marrëveshja e vitit 2001 mbi çështjet e sukcesionit.....	5
Identifikimi i kreditorëve ndërkombëtar dhe fushëveprimi i borxhit të trashëguar të Kosovës	8
Përfundime dhe Rekomandime	14

Shkurtesat

AGIM	Agjencia e Garancisë së Investimeve Multilaterale
ANZH	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BKS	Banka Kombëtare e Serbisë
BNRZH	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
DeP	Deklarata e Pavarësisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GJPA	Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit
KNF	Korporata Ndërkombëtare Financiare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QNZMI	Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Hyrje

1. Ky studim trajton sfondin përkatës që lidhet me çështjen e borxhit ndërkombëtar ose borxhit të jashtëm të trashëguar nga Kosova.
2. Në thelb, ky studim do të organizohet në katër pjesë specifike, duke filluar me (I) burimet e brendshme ligjore dhe fushëveprimin e detyrimit të Kosovës për të përmbushur shlyerjen e borxhit ndërkombëtar të trashëguar; (II) duke eksploruar përvojën e shteteve të tjera të dala nga ish-Jugosllavia; (III) për të definuar kreditorët ndërkombëtar dhe për të matur apo llogaritur përmasën e borxhit të trashëguar, duke përfshirë—për aq sa është e aplikueshme në raste të caktuara—shumat e paguara dhe ato të mbetura. Ky studim përfundon me pjesën IV, e cila përmban përfundimet dhe rekomandimet.

Burimet e brendshme ligjore dhe fushëveprimi i detyrimit të Kosovës për të përmbushur shlyerjen e borxhit ndërkombëtar të trashëguar

3. Kosova shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. Deklarata e Pavarësisë (DeP), megjithëse një akt i Kosovës, e detyron atë ndërkombëtarisht. DeP, duke u bërë publike dhe duke shprehur zotimet dhe qëllimet e qarta dhe konkrete, përfaqëson një fushëveprim të obligimit për Kosovën. DeP shpallë publikisht “që të gjitha shtetet kanë të drejtë të mbështeten në këtë deklaratë, dhe u bënë thirrje atyre që të japin mbështetjen dhe miqësinë e tyre.”¹
4. DeP është shpallur në “pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit të Posaçëm të OKB-së Marti Ahtisaari dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.”² Përmes DeP, Kosova ka pranuar plotësisht obligimet e përfshira në Planin e Ahtisaarit dhe ka përvetësuar kuadrin që ka përcaktuar për të udhëhequr Kosovën në zhvillimin e saj të ardhshëm. “Ne me këtë konfirmojmë, në mënyrë të qartë, në mënyrë të veçantë dhe të pakthyeshme, se

¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008), ‘Deklarata e Pavarësisë së Kosovës.’ Në dispozicion në: https://www.assembly-kosova.org/common/docs/Dek_Pav_e.pdf [Qasur më 13 tetor 2019].

²Po aty, neni 1.

Kosova do të jetë e detyruar ligjërisht të zbatojë dispozitat që përmban kjo Deklaratë, duke përfshirë, veçanërisht, detyrimet për të sipas Planit të Ahtisaarit,”³ është deklarata shumë e qartë dhe e hollësishme e bërë në DeP.

5. Neni 9 i DeP është dispozita që adreson çështjen e suksesimit të Kosovës në traktate dhe detyrime të tjera, të cilat padyshim përfshijnë edhe detyrimet në lidhje me borxhin. Në pjesën relevante për këtë rast theksohet: “Nëpërmes kësaj marrim përsipër detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë ato të lidhura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe traktatit dhe detyrimeve të tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, për të cilat ne jemi të lidhur si një ish-pjesë përbërëse.”⁴ Pra, është e qartë se Kosova ka marrë përsipër të zbatojë traktatet dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura nga UNMIK-u në emër të saj dhe nga ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ).
6. Duhet të bëhet e qartë se Kosova nuk ka marrë përsipër të respektojë traktatin dhe detyrimet e tjera të ndonjë entiteti tjetër, të tillë si Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ), Bashkimi i Serbisë dhe Malit të Zi, ose Republika e Serbisë, siç kanë ekzistuar dhe janë transformuar me kalimin e kohës. Megjithatë, angazhimi i Kosovës për të përmbushur pjesën e detyrimeve të saj që rrjedhin nga ato detyrime të cilat kanë qenë pjesë përkatëse e ish-RSFJ-së është përtej çdo dyshimi.
7. Përveç DeP, natyrisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”) është një instrument tjetër për t’u marrë parasysh. Kushtetuta është miratuar më 9 prill 2008. Ajo hyri në fuqi më 15 qershor 2008 dhe është miratuar, ngjashëm sikurse DeP, në përpunje të plotë me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të përgatitur nga ish-Presidenti Finlandez dhe i Dërguari i Posaçëm i OKB-së për Statusin e Kosovës (S/2007/168 / Add.1) (“Plani i Ahtisaarit”).
8. Pjesa përbërëse e Planit të Ahtisaarit në lidhje me borxhin e trashëguar është Shtojca VI, e emëruar “Borxhi Ndërkombëtar”. Ajo përcakton parimet që drejtojnë

³Po aty. neni 12.

⁴Po aty. neni 9 (me theks të shtuar).

qëndrimin e Kosovës ndaj borxhit ndërkombëtar të trashëguar nga ish-RSFJ-ja ose që ishte pjesë përbërëse e RSFJ-së.

9. Plani i Ahtisaarit parashikon marrjen e borxhit nga Republika e Serbisë, në veçanti Bankës Botërore, Klubit të Parisit dhe kreditorëve të Klubit të Londrës. Metoda për përcaktimin e pjesës së Kosovës është ajo e negociatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

10. Plani i Ahtisaarit gjithashtu ofron disa udhëzime në lidhje me parimet që do të ndihmojnë palët të arrijnë një zgjidhje të negociueshme mbi çështjen e borxhit. Ky udhëzim nënkupton ndjekjen e parimeve të përdorura për alokimin e borxhit të miratuar nga entitetet e tjera që kanë dalur si shtete të pavarura dhe sovrane si rezultat i shpërbërjes së RSFJ-së.

11. Neni 1 i Shtojcës VI të Planit të Ahtisaarit është i artikuluar si më poshtë:

Kosova do të marrë pjesën e borxhit të saj ndërkombëtar të Republikës së Serbisë. Borxhi ndërkombëtar të ndahet duke përfshirë mes të tjerash borxhin ndaj Bankës Botërore, Klubit të Parisit dhe kreditorëve të Klubit të Londrës. Pjesa e Kosovës do të vendoset përmes negociatave në mes Kosovës dhe Republikës së Serbisë duke marrë parasysh parimet e përdorura për shpërndarjen e borxhit sovran në rastin e sukcesionit të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, në marrëveshje me kreditorët përkatës.⁵

12. Neni 2 i Shtojcës së njëjtë qartëson se çfarë ndodh në rast se për borxhin nuk ka pajtueshmëri mes palëve dhe ai nuk është ri-shpërndarë:

Për aq kohë sa për borxhin nuk është pajtuar plotësisht dhe nuk është ri-shpërndarë në marrëveshje me kreditorët, Republika e Serbisë,

⁵Kuvendi i Republikës së Kosovës (2007), 'Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.' Në dispozicion në: <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Comprehensive%20Proposal%20.pdf> [Qasur më: 13 tetor 2019].

bazuar në përgjegjësinë e saj si huamarrëse/garantuese, do të sigurojë vazhdimin e servisimit të borxhit. Kosova do të rimburojë në Republikën e Serbisë pjesën e rregullt të përcaktuar të Kosovës nga servisimi i borxhit që Republika e Serbisë ka paguar në pritje të përfundimit të procesit të pajtimit të borxhit.⁶

13. Në mungesë të një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Plani i Ahtisaarit parashikon arbitrazhin si metodë institucionale për të zgjidhur çështjen e pajtimit dhe shpërndarjes së borxhit. Neni 3 i Shtojcës VI të Planit përmban:

3.1 Nëse brenda një viti pasi që kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi, Kosova dhe Republika e Serbisë nuk kanë rënë dakord për pajtueshmërinë dhe alokimin e borxhit, Grupi Drejtues Ndërkombëtar do të emëroj një arbitër ndërkombëtar pas konsultimit me palët, për shpërndarjen e borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë dhe Kosovës, ose asaj pjese të borxhit ndërkombëtar për të cilën palët nuk janë pajtuar, në marrëveshje me kreditorët përkatës.

3.2 Alokimi i borxhit nga arbitri do të jetë i pakthyeshëm dhe do të vendos cilat borxhe do të transferohen në Kosovë.⁷

14. Në lidhje me kreditorët e referuar në Nenin 1 të Shtojcës VI, duhet të bëhet e qartë se Kosova është anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të vetmet agjenci të specializuara të Kombeve të Bashkuara në të cilat Kosova është anëtare. Grupi i Bankës Botërore përbëhet nga pesë institucione ndërkombëtare: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZh), Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (ANZh), Korporata Ndërkombëtare Financiare (KNF), Agjencia e Garancisë së Investimeve Multilaterale (AGIM) dhe Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (QNZMI). Në aspektin e anëtarësimit, Banka Botërore aktualisht ka 189 Shtete, njejtë sikurse FMN-ja.

⁶Po aty. shtojca VI, neni 2.

⁷Po aty. shtojca VI, neni 3.

- 15.** Kosova është pranuar në FMN dhe në Grupin e Bankës Botërore në vitin 2009. Marrëveshja e anëtarësimit ka hyrë në fuqi më 29 qershor 2009.
- 16.** Për sa u përket kreditorëve të tjerë të referuar në Nenin 1 të Shtojcës VI të Planit të Ahtisaarit, Klubi i Parisit është një grup joformal i zyrtarëve nga shtetet e mëdha kreditore që për mision kanë të gjejnë zgjidhje të koordinuara dhe të qëndrueshme për vështirësitë në pagesa të përjetuara nga shtetet debitore. Gjithashtu, Klubi i Kreditorëve të Londrës është një grup joformal i kreditorëve privat në nivelin ndërkombëtar, dhe është i ngjashëm me Klubin e Parisit.⁸

Përvoja e ish-shteteve të tjera jugosllave: Marrëveshja e vitit 2001 mbi çështjet e suksesionit

- 17.** Shpërndarja e borxhit sovran në rastin e suksesionit të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë është vendosur përmes një marrëveshjeje shumëpalëshe të lidhur nga shtetet e reja të cilat ishin themeluar pas shpërbërjes së RSFJ-së. Në të vërtetë, marrëveshja merret me çështjet e suksesionit që i takojnë *(a)* pronës së luajtshme dhe të paluajtshme; *(b)* pronave diplomatike dhe konsullore; *(c)* aseteve financiare dhe detyrimeve; *(d)* arkivës; *(e)* pensioneve; *(f)* të drejtave, interesave dhe detyrimeve tjera; dhe *(g)* pronës private dhe të drejtave të fituara.
- 18.** Kjo marrëveshje, e njohur si Marrëveshja e Çështjeve të Sukcesionit ose Marrëveshja Jugosllave mbi Çështjet e Sukcesionit (shkurt “Marrëveshja e vitit 2001” ose “Marrëveshja e Sukcesionit Jugosllav”), është përfunduar në vitin 2001 në Vjenë. Palë në këtë Konventë janë Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Sllovenia dhe Republika Federale e Jugosllavisë.
- 19.** Sukcesioni i shteteve në lidhje me asetet dhe detyrimet e ish-RSFJ-së ka qenë në pritje për një kohë të gjatë për shkak të regjimit të Millosheviqit. Për disa vite,

⁸Market Business News (2019), ‘Çka është Klubi i Parisit is Paris? Definicioni dhe Kuptimi.’ Në dispozicion në: <https://marketbusinessnews.com/financial-glossary/paris-club-definition-meaning/> [Qasur më 13 tetor 2019].

qëndrimi i RFJ-së pengoi marrëveshjet në mes të pesë shteteve suksesore të RSFJ-së. RFJ-ja pretendonte të paraqiste vazhdimësinë ekskluzive ligjore dhe politike të RSFJ-së pas shpërbërjes së federatës, duke lënë katër republikat tjera vetëm me një pjesë të vogël të aseteve dhe pronave të ish-RSFJ-së. Megjithatë, ndryshimi i regjimit në Serbi në tetor të vitit 2000 hapi rrugën për përfundimin e Marrëveshjes së Sukcedimit Jugosllav. Përndryshe, negociatat rreth kësaj marrëveshjeje kanë filluar në vitin 1992 brenda kornizës së Grupit të Punës për Çështjet e Sukcedimit të Konferencës Ndërkombëtare mbi ish-Jugosllavinë të themeluar nga Kombet e Bashkuara dhe Komuniteti Evropian. Më vonë, negociatat vazhduan nën patronazhin e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë.

20. Marrëveshja e vitit 2001 e definon borxhin e jashtëm, si dhe metodën e shpërndarjes së atij borxhi. Kështu, “borxhi i jashtëm ... është përshkruar si borxh i shpërndarë nëse përfituesi përfundimtar i atij borxhi ndodhet në territorin e një shteti suksesor specifik ose grupi të shteteve suksesore. Borxhi i alokuar nuk është subjekt i sukcesionit dhe do të pranohet nga suksesori në territorin e të cilit ndodhet përfituesi përfundimtar.”⁹

21. Marrëveshja e Sukcesionit Jugosllav pra miraton parimin e territorialitetit të përfituesit përfundimtar; nëse, për shembull, borxhi ka rezultuar nga një huazim që është pranuar për një investim në Kroaci, ai borxh ose çdo pjesë e mbetur e tij do të ndahet në Kroaci. Sipas logjikës së njejtë, nëse përfituesi ndodhet në territorin e Kosovës, borxhi do t'i ndahet ose takojë Kosovës.

22. Është e rëndësishme të theksohet se Marrëveshja e vitit 2001 njeh faktin se disa prej shteteve suksesore tashmë kanë arritur marrëveshje në mes vete ose në mes tyre individualisht dhe institucioneve në të cilat ato kanë fituar anëtarësinë. Situata e fundit do të ishte e zbatueshme në lidhje me Kosovën dhe anëtarësimin e saj në FMN dhe Bankën Botërore dhe, më vonë, gjithashtu në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh).

⁹United Nations Treaty Collections (2001), ‘Marrëveshja mbi Çështjet e Sukcesionit, Vjenë, 29 Qershor 2001.’ Në dispozicion në: https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?chapter=29&clang=en&mtdsg_no=XXIX-1&src=TREATY [Qasur më 14 tetor 2019].

23.Neni 3 i Shtojcës C (Asetet Financiare dhe Detyrimet) e Marrëveshjes Jugosllave të Sukcesionit:

(1) Një pjesë e madhe e asetëve dhe detyrimeve të RSFJ-së tashmë janë shpërndarë në praktikë në bazë të marrëveshjeve në mes shteteve suksesore ose marrëveshjeve në mes tyre individualisht dhe institucioneve të interesuara, do të thotë:

(a) Pjesa e asetëve dhe detyrimeve të RSFJ-së të Fondit Monetar Ndërkombëtar;

(b) pjesët e Bankës Botërore dhe institucionet e saj përkatëse të mbajtura nga RSFJ-ja;

(c) detyrimet e RSFJ-së në Bankën Botërore;

(d) pjesët e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankës Afrikane të Zhvillimit dhe Bankës Ndër-Amerikane të Zhvillimit të mbajtur nga RSFJ-ja;

(e) borxhet e RSFJ-së në Bankën Evropiane të Investimit; ...¹⁰

24.Duke pasur parasysh datën e pavarësisë së Kosovës dhe fazën aktuale të negociatave politike, kushdo që është i përfshirë në procesin negociator duhet të zbatojë—dhe atë në mënyrë të natyrshme—parimet e miratuara nga, dhe të zbatuara kundër, njërive të tjera të ish-RSFJ-së gjithashtu për alokimin e borxhit sovran midis Kosovës dhe Serbisë.

¹⁰Po aty, neni 3.

Identifikimi i kreditorëve ndërkombëtar dhe fushëveprimi i borxhit të trashëguar të Kosovës

25. Siç është theksuar tashmë, Kosova u pranua si anëtare në FMN dhe Grupin e Bankës Botërore më 29 Qershor 2009, pas më shumë se një viti pas shpalljes së pavarësisë. Procedura dhe procesi përkatës është përcaktuar në Ligjin për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizatën e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Grupit të Bankës Botërore.¹¹ Këto janë dy agjencitë e vetme të specializuara të OKB-së në të cilat Kosova është deri tani anëtare.
26. Kosova u anëtarësua në BERZh, një tjetër institucion financiar, më 17 dhjetor 2012. Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Krijimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim shënon hapin përfundimtar në këtë proces të anëtarësimit.¹²
27. Borxhi ndërkombëtar i trashëguar i Kosovës në lidhje me FMN-në dhe Grupin e Bankës Botërore është i përcaktuar në Marrëveshjen e Marrjes së Kredisë midis BNRZh-it dhe Kosovës.¹³
28. Sa i përket 29 qershorit 2009, datës së anëtarësimit të Kosovës në Bankën Botërore, vlera e papaguar e shumës së kredisë së konsoliduar C arrin shumën treqind e tetëdhjetë e një milion e dyqind e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro dhe nëntëdhjetë cent (€381,208,965.90).¹⁴ Duhet theksuar se shuma totale që RFJ-ja, më vonë Serbia, duhej t'i paguante Bankës Botërore në lidhje me Kosovën ishte katërqind e tridhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë euro dhe katër cent (€430,695,928.04). Kjo shumë

¹¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2009), 'Ligji Nr. 03/L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizatën e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Grupit të Bankës Botërore' Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2639> [Qasur më 15 tetor 2019].

¹² Kuvendi i Republikës së Kosovës (2012), 'Ligji Nr. 04/L-169 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Krijimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim' Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11176> [Qasur më 15 tetor 2019].

¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2009), 'Marrëveshja e Marrjes së Huasë midis Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Republikës së Kosovës' Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8482> [Qasur më 15 tetor 2019].

¹⁴Po aty. shkronja G.

është definuar dhe përcaktuar në Marrëveshjen e Kredisë të vitit 2001 në mes të BNRZh-it dhe RFJ-së, kur RFJ-ja arriti të trashëgojë anëtarësinë e RSFJ-së.

- 29.** Kjo do të thotë se RFJ-ja, më pas Serbia, duhej t'i paguante Bankës Botërore në lidhje me Kosovën (nga viti 2002 deri në vitin 2009) dyzet e nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy euro dhe katërmëdhjetë cent (€49,486,962.14) deri në marrjen e kredisë së Kosovës (ose borxhit të trashëguar) në vitin 2009.
- 30.** Kreditë e Konsolidimit në mes të BNRZh-it dhe RFJ-së ishin të negociuara në nëntor të vitit 2001. Ato hynë në fuqi më 8 janar të vitit 2002. Procesi i konsolidimit kishte tre përbërës kryesor: (i) llogaritjen e vlerës kryesore të papaguar për çdo kredi ekzistuese të RFJ-së; (ii) llogaritjen e vlerës së kapitalizuar të borxheve të interesit dhe pagesave të vonuara (për të përfshirë edhe interesin mbi pjesën kryesore të vonuar që ende nuk ishte faturuar) për secilën kredi, që do t'i shtohet vlerës kryesore të papaguar për të përcaktuar një vlerë kryesore të përditësuar të çdo kredie që do të konsolidohet; dhe (iii) shpërndarjen e këtyre kredive ekzistuese nëpër gjashtë Kreditë e Konsoliduara (A në F).
- 31.** Kreditë A, B dhe C kreditë e konsoliduara (ose pjesët e kredive) ishin marrë në dobi të Serbisë dhe Kosovës. Tre nga gjashtë kreditë (D, E dhe F) kanë konsoliduar kreditë ekzistuese të BNRZh-it (ose pjesë të kredive) të cilat konsiderohet se janë marrë në dobi të Malit të Zi. Pas pavarësisë së saj në vitin 2006, Mali i Zi nënshkroi një Marrëveshje për marrjen e huasë për secilën prej këtyre kredive pas nënshkrimit të Neneve të Marrëveshjes së BNRZh-it dhe ShZhN-së.
- 32.** Gjatë negociatave në mes të BNRZh-it dhe RFJ-së në anëtarësimin e fundit, RFJ-ja propozoi të konsolidoj të gjitha kreditë ekzistuese (ose pjesët e kredive) të cilat ishin marrë në dobi të Kosovës në një hua të vetme: Kredia e Konsoliduar C (KKC). Kjo kredi, bashkë me kreditë e tjera të konsoliduara, hyri në fuqi më 8 janar të vitit 2002.
- 33.** KKC konsolidoi njëmbëdhjetë kredi të plota dhe pjesë të shtatë kredive të tjera, të

gjitha të marra në mes të viteve 1970 dhe 1983. Të gjitha tetëmbëdhjetë kreditë kishin vlerën kryesore të papaguar ose interesin për shkak se në atë kohë KKC ishte negociuar. Kjo shpërndarje, sikurse edhe me kreditë e tjera të konsoliduara, u bazua në një metodologji të ngjashme me atë të zbatuar në rastet e mëparshme të ndarjes së borxhit të jashtëm të republikave të tjera ish-Jugosllave.

34. Serbia, si huamarrësi i regjistruar, ka servisuar Kredinë e Konsoliduar C që nga viti 2002. Vlera origjinale e KKC—siç është theksuar tashmë—ishte €430.7 milionë. Pas pagesës së datës 15 mars 2009, balanci i mbetur ishte €381.2 milionë.

35. Marrëveshja e marrjes së kredisë përcakton në mënyrë të qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e Kosovës në lidhje me detyrimet e trashëguara të borxheve nga RFJ-ja dhe Serbia, respektivisht:

Seksioni 2.01. Republika e Kosovës në këtë mënyrë pranon të drejtat dhe përfitimet, dhe merr detyrimet, e Republikës së Serbisë (gjithashtu e referuar si “ish- huamarrësi”) të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Marrjes së Kredisë, duke përfshirë detyrimet për të paguar vlerën, interesin dhe të tjera pagesa, dhe të kryej aktivitetet të përcaktuara dhe përmendura në Marrëveshjen e Marrjes së Kredisë.

Seksioni 2.02. Banka në këtë mënyrë vërteton, konfirmon dhe pranon marrjen e detyrimeve nga Republika e Kosovës të përcaktuara në Seksionin 2.01. të Marrëveshjes së Marrjes.

Seksioni 2.03. Të gjitha veprimet e marra, të drejtat e fituara ose detyrimet të shkaktuara sipas Marrëveshjes së Marrjes së Kredisë nga Republika e Serbisë do të jenë të vlefshme dhe të detyrueshme në Republikën e Kosovës.¹⁵

¹⁵Po aty, neni 2.

36. Në vitin 2009, me pranimin e Kosovës në Bankën Botërore, një total prej 123.7 milionë Eurosh iu paguan Bankës Botërore si pjesë e trashëguar e borxhit prej €381.2 milionë – Kredia e Konsoliduar C. Kjo shumë, megjithatë, u pagua me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, prej të cilëve Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte donatori kryesor. Tabela 1 e mëposhtme paraqet detajet e pagesës së parë të bërë në vitin 2009:

Tabela 1: Pagesat e bëra në vitin 2009- Kredia e Konsoliduar C (Banka Botërore)

Viti	2009
Shteti/Organizatrat	Shuma (në milion Euro)
Republika e Kosovës	34.59
Shtetet e Bashkuara	84.12
Komisioni Evropian (Bashkimi Evropian)	5.00
Shuma totale	123.71

37. Që nga viti 2009 deri më sot, 110.5 milionë euro të tjera u paguan nga Kosova ndaj borxhit të trashëguar të Bankës Botërore. Kjo përmban një total të shumës prej 234.24 milionë euro tashmë të paguara.

38. Borxhi i mbetur i Kosovës ndaj Bankës Botërore aktualisht qëndron në 146, 97 milionë euro. Kosova është vendosur të paguaj këtë borxh deri në vitin 2031.¹⁶

¹⁶Këto të dhëna janë marrë nga Ministria e Financave *Të dhënat tremujore mbi borxhin total*, Tetor 2018. Ato gjithashtu janë rikonfirmuar nga Zyrtarët e Lartë nga Ministria e Financave që merren me bashkëpunimin financiar ndërkombëtar dhe çështjet e borxhit.

- 39.**Zyrtarët nga Ministria e Financave dhe institucioneve të tjera përkatëse nuk ishin në gjendje të konfirmojnë pjesën tjetër të kreditorëve dhe shumën e borxhit të trashëguar të Kosovës nga kohët e RSFJ-së. Ata kanë përmendur mungesën e të dhënave zyrtare ose regjistrimeve si arsye për paaftësinë e tyre për të konfirmuar ose siguruar shumën e trashëguar ndaj shumës që i detyrohet kreditorëve të tjerë.
- 40.**Në mënyrë alternative, një burim i të dhënave që ishte i disponueshëm dhe mund të merret si pikë referimi është llogaria zyrtare e dhënë publikisht nga Banka Kombëtare e Serbisë (BKS) në lidhje me borxhin e trashëguar të Kosovës që ajo ka marrë përsipër ta paguaj. Media të shumëfishta të lajmeve në Kosovë dhe Serbi kanë publikuar këto të dhëna.¹⁷
- 41.**Sipas të dhënave të BKS-së, Serbia ka marrë përsipër për të paguar borxhin prej 932.73 milionë eurosh i cili ishte shkaktuar në mes të viteve 1970 dhe 1990 në dobi të Kosovës. Tashmë ka paguar afro 650 milionë euro, dhe ka pak më shumë se 300 milionë të mbetura për t'u paguar kreditorëve të ndryshëm. Ky borxh ishte ristrukturuar gjatë viteve 2002-2005, dhe Serbia nuk është duke paguar ndonjë borxh të jashtëm që Kosova ka shkaktuar që atëherë.
- 42.**Sipas të dhënave të BKS-së, borxhi i trashëguar që Serbia ka marrë përsipër të paguaj në lidhje me Kosovën është borxh ndaj kreditorëve kryesorë në vijim në shumat e përcaktuara në Tabelën 2.

¹⁷ *Shih*, për shembull, "Serbia paguan borxhin miliardesh të Kosovës", e disponueshme në: <https://kallxo.com/serbia-paguan-borxhin-miliardesh-te-kosoves>; "Serbia po shlyen borxhin një miliard euro të Kosovës", e disponueshme në: <https://www.reporter.al/serbia-po-shlyen-borxhin-nje-miliard-euro-te-kosoves>; "Serbia Pays Off Kosovo's Billion Euro Debt", e disponueshme në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/serbia-covers-kosovo-s-billion-euro-debt-07-11-2017>; "Serbia paguan borxhe të Kosovës deri në vitin 2041", e disponueshme në: <https://www.koha.net/arberi/30072/serbia-paguan-borxhe-te-kosoves-deri-ne-vitin-2041>; "Serbia thotë se ia paguan borxhet Kosovës deri në vitin 2041", e disponueshme në: <https://www.gazetaexpress.com/lajme/serbia-thote-se-i-paguan-borxhet-kosoves-deri-ne-vitin-2041-400644/?archive=1>; "Serbia thotë se i paguan borxhet Kosovës deri në vitin 2041", e disponueshme në: <http://lajmi.net/serbia-thote-se-i-paguan-borxhet-kosoves-deri-ne-vitin-2041>

Tabela 2: Kreditorët kryesorë të tjerë përveç Bankës Botërore – sipas BKS-së

Nr.	Kreditori	Shuma e borxhit (milion Euro)
1.	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	433.31
2.	Klubi i Parisit	297.2
3.	Klubi i kreditorëve të Londrës	169.85

43. Shuma më të vogla janë të raportuara nga BKS-ja që janë trashëguar në lidhje me kreditorët e mëposhtëm dhe në shumat e rendituara në Tabelën 3.

Tabela 3: Kreditorët e vegjël dhe borxhi i trashëguar nga ata – sipas BKS-së

Nr.	Kreditori	Shuma e borxhit (milion Euro)
1.	Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës	5.79
2.	Kompania Evropiane e Hekurudhave <i>Eurofima</i>	4.62
3.	Shteti i Kuvajtit	18.1
4.	Bashkimi Evropian	0.43 <i>(430 mijë)</i>
5.	Libia	3.44
6.	Ish- Çekosllovakia	1.57

44. Sipas të dhënave të BKS-së, Serbia aktualisht i detyrohet 304.54 milionë euro Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Klubeve të Parisit dhe Londrës, si dhe Kuvajtit. Borxhi i BERZh-it është për t'u ripaguar deri në muajin dhjetor të

vitit 2031, borxhi i Klubit të Parisit deri në mars të vitit 2041, Klubit të Londrës deri në vitin 2024, dhe Kuvajtit deri në korrik të vitit 2034.

45. Serbia ka marrë përsipër pjesën e borxhit të Kosovës të ish-RSFJ-së në vitin 1991 pas heqjes së dhunshme të statusit të saj autonom në ish-federatë. Pas asaj, Serbia pagoi borxhet e Kosovës deri kur sanksionet e Kombeve të Bashkuara u vendosën ndaj RFJ-së në vitin 1992. Ajo rifilloi të paguaj borxhet në vitin 2001 pas anëtarësimit në OKB dhe anëtarësimit në organizata të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare.
46. Si pjesë e procesit të negociatave, zyrtarët e Republikës së Kosovës duhet të kërkojnë nga homologët serbë dokumentacionin zyrtar që Republika e Serbisë e posedon në lidhje me çështjen e borxhit të trashëguar ndërkombëtar, si dhe shumat e dokumentuara që tashmë i kanë paguar.
47. Kosova duhet të rishikoj dokumentacionin e dorëzuar me kujdesin dhe ekspertizën e duhur. Një dokumentacion i tillë ose çdo pretendim i paraqitur nga Republika e Serbisë gjithashtu mund dhe duhet të verifikohet me kreditorët përkatës.

Përfundime dhe Rekomandime

- I. Kosova ka pranuar marrjen e pjesës së saj të borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë në bazë të parimeve të përdorura për ndarjen e borxhit sovran në rastin e republikave të tjera të ish-RSFJ-së. Siç shfaqet në këtë studim, Marrëveshja e Sukcesionit Jugosllav e vitit 2001 koncepton borxhin e jashtëm si “borxh të alokuar nëse përfituesi përfundimtar i atij borxhi ndodhet në territorin e një shteti specifik suksesor...Borxhi i alokuar do të pranohet nga suksesori në shtetin e të cilit ndodhet përfituesi përfundimtar.” Kosova përveç kësaj ka demonstruar qëllimin e saj për të marrë përsipër këtë detyrim ndërkombëtar përmes anëtarësimit të saj në FMN dhe Bankën Botërore dhe marrjen dhe vazhdimin e ripagimit të pjesës

së borxhit të saj. Kosova duhet të përpiqet të gjejë zgjidhje për çështjen e borxhit me Republikën e Serbisë në bazë të praktikës së ratifikuar në Marrëveshjen e Sukcesionit të Jugosllavisë të vitit 2001. Megjithatë, në mënyrë që të arrihet një marrëveshje e mundshme, Republika e Serbisë, duhet të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që posedon në lidhje me borxhin e trashëguar dhe me shumën e borxhit të shërbyer (*serviced debt*). Kosova gjithashtu mund të vendos kontakt me kreditorët përkatës për qëllime të verifikimit dhe konfirmimit të të dhënave.

- II.** Gjatë procesit të negocimit, Kosova paralelisht me marrjen e borxhit ndërkombëtar të trashëguar, duhet të kërkojë që çështjet e trashëgimisë së pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme të prekshme të pronës shtetërore—përfshirë atë publike dhe shoqërore—të RSFJ-së (të pasuar nga Serbia) të zgjidhen në përputhje me parimet e Marrëveshjes së Sukcesionit të Jugosllavisë të vitit 2001, që do të thotë se prona kalon “në shtetin suksesor në territorin e së cilës ndodhet kjo pronë.” Përveç kësaj, Kosova mund të pretendojë në mënyrë të vlefshme - dhe duhet të këmbëngulë - që pronat diplomatike dhe konsullore të RSFJ-së të trashëguara nga Republika e Serbisë të shpërndahen proporcionalisht me Republikën e Kosovës.
- III.** Nëse palët nuk janë në gjendje të arrijnë një mirëkuptim përmes negociatave, Kosova duhet në mënyrë alternative të synoj për një marrëveshje përmes arbitrazhit. Plani i Ahtisaarit ka parashikuar tashmë arbitrazhin si një mekanizëm të mundshëm për të zgjidhur çështjen e borxhit të trashëguar ndërkombëtar në mes Kosovës dhe Serbisë, ose çfarëdo pjese të borxhit për të cilën palët nuk janë në gjendje të bien dakord. Në atë kohë, Plani parashikoi Grupin Drejtues Ndërkombëtar si organin emëruar të arbitrit (“Nëse ... Kosova dhe Republika e Serbisë nuk kanë rënë dakord për pajtueshmërinë dhe shpërndarjen e borxhit, Grupi Drejtues Ndërkombëtar do të emëroj një arbitër ndërkombëtar pas konsultimit me palët, për shpërndarjen e borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë në mes të Republikës së Serbisë dhe Kosovës, ose për atë pjesë të

borxhit ndërkombëtar që palët nuk kanë arritur të bien dakord, në marrëveshje me kreditorët përkatës.”). Megjithatë, duke pasur parasysh rrethanat e ndryshuara, Kosova në këtë fazë mund të ndjekë dy rrugë të mundshme:

(a) Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit (GjPA). Fuqia e emërimit të arbitrit (ave) duhet t’i mbetet Sekretarit të Përgjithshëm të GjPA-së. Kosova tashmë është anëtare e GjPA-së, të cilës i është bashkuar që nga viti 2016.

Ose:

(b) Një gjykatë e arbitrazhit që do të krijohet nga Bashkimi Evropian ose, më konkretisht, Komisioni Evropian në emër të tij. Varësisht nga dallimet e vazhdueshme dhe kompleksiteti i perceptuar, Kosova mund të kërkojë një trup prej tre arbitrave, në krahasim me një arbitër të vetëm, siç thuhet në Planin e Ahtisaarit. Është sigurisht vendimtare që arbitërat të kenë, përtej standardeve të kërkuara të reputacionit ose integritetit profesional, përvojë dhe ekspertizë të demonstruar për çështjet e sukcesionit së shtetit dhe shpërndarjes së borxhit sovran. Vendimi i arbitrazhit është sipas definicionit përfundimtar (përveç nëse palët në mënyrë specifike bien dakord të parashikojnë mundësinë e rishikimit, duke përfshirë afatin kohor për të).

